

VENDIM
Nr. 27, datë 16.5.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KRIJIMIN, LICENCIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BANKËS URË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe nenit 81/1 pika 1 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani